2. Imsak tj. ustezanje od jela, pića, spolnog odnosa i svega drugog što kvari post.

ŠTA KVARI POST?

1. Jelo i piće

Onaj ko pokvari post jelom i pićem dužan je napostiti te done. Pod ovim se podr-

azumijeva namjerno jedenje i pijenje. Međutim ako bi neko jeo ili pio u zaboravu ili greškom, ne mora napostiti. Poslanik, a.s., je rekao: «Ko zaboravi da posti, pa pojede nešto ili se napije vode, neka nastavi sa postom, jer Allah ga je nahranio i napojio».

2. Poslanik, a.s., je rekao: «Koga nadvlada nagon za povraćanjem, nije dužan napostiti, ali ako neko namjerno prouzrokuje povraćanje, neka naposti taj dan».

3. Hajz i Nifas

Ako žena dobije menstruaciju ili se porodi, pa makar se to desilo na trenutak prije zalaska sunca, post je pokvaren i nužno ga je napostiti.

4. Namjerno izazivanje izlaska sjemena (ejakulacija).

ŠTA JE POSTAČU DOZVOLJENO ?

1. Postaču je dozvoljeno kupanje i rashlađivanje vodom.

2. Podvlačenje surme i upotreba kapi za oči i slično dozvoljeni su pa makar osjetio ukus u grlu, ali je bolje to odgadati do uvečer.

3. Poljubac postača. U hanefijskom mezhebu poljubac je mekruh samo ako izazove strast, ali u svakom slučaju za postača je bolje ostaviti se toga.

4. Injekcije bez obzira davala se u venu ili negdje drugo, ali da nije hranjive prirode.

5. Puštanje krvi. Postaču je dozvoljeno puštanje krvi, osim ako to utiče na fizičko slabljenje postača. Davanje krvi za laboratorijske analize i slično je dozvoljeno.

6. Ispiranje usta i nosa. Dozvoljeno je ispiranje usta i nosa ali je mekruh u tome pretjerivati.

7. Stvari od kojih se ne može čuvati, a dozvoljene su kao na primjer: gutanje pljuvačke, prašina koja je na putu, slina itd.

8. Postaču je dozvoljeno da osvane džunup, kao što je dozvoljeno ženi koja je bila u hajzu ili nifasu, pa joj je prestalo krvarenje, da zaposti prije kupanja, a kupanje može odgoditi do iza zore, s tim mora zanijetiti post, a kupanje mora obaviti prije isteka namaskog vremena.

TRAŽENJE NOĆI KADRA (NAJVRIJEDNIJE NOĆI)

Lejletu-l-kadr bolja je od 1000 mjeseci. Ona se nalazi u zadnjih deset neparnih noći Ramazana. Od Aíše, r.a., se prenosi da je rekla: «Rekla sam - O Allahov Poslanice, kada bih znala u kojoj je noći Lejletu-l-kadr, šta bih u njoj činila? - a on je odgovorio - Reci, Allahu moj, Ti si Onaj koji opraštaš, voliš da opraštaš, pa mi oprosti». (Buhari i Muslim).

Ebu Hurejre, r.a., prenosi da je Vjerovjesnik, a.s., rekao: «Ko posti Ramazan, vjerujući nadajući se nagradu, oprošteno su mu (mali) grijesi koje je do tada počinio». (Muttefequn alejhi).

O braćo muslimani i sestre muslimanke, iskoristite mjesec Ramazan, iskreno čineći tevbu Allahu Uzvišenom. Možda am se ova prilika neće drugi put ponoviti. Zaista onaj ko se iskreno nepokaje u Ramazanu, u mjesecu kada su šejtani okovani u lance kada će to učiniti...

Isnam Taljić, autor knjige «Roman o Srebrenici»

Muslimanima je čitanje farz



- * Nejedinstvo je vječno prokletstvo muslimana
- * Previše je godina u kojima su «mršave krave jele debele»

Nakon 15 objavljenih knjiga prevedenih na više svjetskih jezika, Isnama Taljića mnogi smatraju najboljim savremenim bošnjačkim proznim piscem. Već godinama, ovaj rođeni Vlaseničanin, "Romanom o Srebrenici", kao i knjigama "Vjetrometina", "Kuća na Drini" ili "Put iz Mekke" iskreno pripovijeda priče o usudu balkanskih muslimana, prije svih Bošnjaka. Napisana u majstorskom pripovjedačkom maniru i prokana islamskim nitima, njegova djela uvrstila su Taljića u više savremenih domaćih i stranih izbora i antologija bosansko-hercegovačke književnosti. Jedini bosanski pisac koji je ušao u antologiju savremene svjetske pripovijetke Međunarodnog literarnog festivala u Maleziji (2004. godine) govori za naš časopis.

Ove godine u svijetu je obilježena godišnjica masakra u Srebrenici. Iz pozicije književnika koji je napisao roman o tome gradu, možete li reći šta danas za Bošnjake znači Srebrenica? Kakav je njihov odnos prema događajima iz jula 1955. godine, deceniju nakon toga?

Taljić: Takvi kakvi smo, «izgurali» smo da se desetogodišnjica genocida nad Bošnjacima veličanstveno obilježi. U tome nam je pomogao i svijet, koji je, isto tako, doprinio našoj tragediji. Ali, ogroman broj Bošnjaka i u Bosni i izvan Bosne, tako i onih stotinu hiljada koji su nastojali doći u Potočare, bili su mnogobrojni «kamenčići» i vlastitim

doprinosom upotpunjavali taj ukupni «mozaik» dostojanstvenosti 11. jula 2005. godine. E, sad bi najgore bilo ukoliko bismo se i u tome predali samozadovoljstvu, pa se opet «probudili» tek pred 11. juli 2006. ili 11. juli 2010. godine. Time bi se Srebrenica svela na formu, na puko obilježavanje godišnjica. To kako je bilo sa 11. julom ove godine, to mora biti podstrek Bošnjacima da im Srebrenica ne prestano bude u mislima, da je ne smetnu s uma, da se njome suočavaju iz dana u dan i organiziranjem raznih manifestacija. Srebrenica treba biti simbol ukupne bošnjačke borbe i stradanja, treba biti naša metafora koja ne isključuje nego, naprotiv, podrazumijeva i druge krajeve i gradove u kojima su se borili i stradali Bošnjaci. Tim kontinuitetom bismo se mogli oduprijeti na

šoj teškoj bolesti nestajanja u samozaboravu. Ovogodišnji 11. juli je pokazao da to možemo. U tome se trebamo učiti od drugih. Znamo dobro šta su i koliko su Jevreji uspjeli ne dozvoljavajući ni sebi ni svijetu da se nadvije zaborav nad njihovim stradanjem. To su postigli na razne načine, tako i umjetničkim djelima, knjigama, filmovima. Od te strategije oni ne odustaju i to treba da imamo na umu. Ako govorimo o čuvanju povijesnog sjećanja kroz umjetnost, sjetimo se Guernike u Španiji i toga šta je na osudi zločina postignuto Picasovom slikom s tim naslovom.

Gotovo da je prošla i decenija od potpisivanja Dejtonskog sporazuma. Koliko su Bošnjaci danas, nakon deset godina mira, svjesni i spremni da se opomenu iz godina agresije?

Taljić: Bošnjaci su dugo odvikavani od sebe i ne treba im skroz zamjeriti na «nesna-

laženju» u ovim postdejtonskim godinama. Isto tako, Bošnjaci trebaju shvatati da je bilo previše godina u kojima su «mršave krave jele debele krave» i da ne smiju sebi dozvoliti razbacivanje s vremenom. Ne moraju previše ni tražiti za «izgubljenim vremenom», jer su nam opomene prošlosti prečeste i preteške, ali bismo se napokon morali dozvat pami. Treba se nadati da se taj proces ipak odvija.

Bosna i islam se, nekako, smatraju dvjema stranama istoga novčića. Nakon vjerskog buđenja tokom rata, opet se čuju glasovi koji vjersko izjednačavaju sa nazadnim, a žrtve umanjuju. Može li se dogoditi da, kao nekad dede sa francuzicima, majke šehida sa svojim bijelim mahramama ostaju jedni simboli islama na ovim prostorima i jedina opomena da se od svojih korijenja ne može pobjeći?

Taljić: Hajde da samo ne

kritiziramo druge, da se i samokritiziramo. Hajde da kao književnik, u moru toga što ne bi trebalo biti kako jest, kao posebnu «priču» izdvojim knjige koje se kod nas štampaju o vjerskim temama i prodaju na prostorima gdje žive Bošnjaci. To je bruka i sramota šta se sve objavljuje, i ko sve objavljuje, i ko to i kako prevodi. Demokratija se na našim prostorima i inače provodi na način anarhije, kao totalno bezakonje. Nikava nedemokratičnost ne bi bila da se takvome izdavaštvu stane ukraj. Istjerat će nas iz vjere te silne «vjerske» knjige! I u samoj književnosti mnogi pisci progone u načinu tretiranja islama. Mnogi književnici bi sada «podučavali» islamu hodže, čak i muftije. Islam se, naravno, treba tretirati i u književnosti, ali ne na vulgaran način, jer je to nesuvlaslo. Islam se treba podrazumijevati kao što podrazumijevamo udisanje zraka da bismo živjeli.

Svijet me više priznaje

Za englesko izdanje Vašeg "Romana o Srebrenici" predgovor je napisao bivši malezijski premijer dr. Mahatir Muhammed. Imali ste čast kakva se rijetko ukazuje piscu iz male zemlje kakva je Bosna. Je li Isnam Taljić priznatiji u Bosni ili u svijetu?

Taljić: Priznatiji sam u svijetu. To nije neskromnost, to je tako. Bošnjačke institucije, osim Islamske zajednice, ne postoje u Bosni, a Bošnjaci u multikulturalnim forumima se dodvoravaju Srbima i Hrvatima mnogo više nego što se to od njih očekuje, pa, između ostalog, nastoje eliminirati one koji se ne libe da budu Bošnjaci. Osim što je objavljen na engleskom i što je predgovor napisao dr. Mahathir, «Roman o Srebrenici» je preveden na turski i upravo se prevodi na više jezika, a u Maleziji sam prošle godine uvršten u izbor savremenih svjetskih pripovjedača. Međutim, i sami Bošnjaci su sada – svijet. Raseljeni su širom svijeta, čak u 184 zemlje. Znam da oni čitaju moje knjige i znam da drže do njih. Nejam neki marketing, ali ljeti, kad Bošnjaci iz dijasporu nahrpu u Sarajevo, moje knjige su najtraženije u jedinjoj knjižari u kojoj se prodaju; to je glavna knjižara «Svjetlosti». Znam to i po naredbama iz svijeta.



Od optužbi da je Ivo Andrić gajio prikriveni animozitet prema muslimanima, do nazivanja Meše Selimovića srpskim piscem, bosanska književnost je uvijek bila žrtva tuđih aspiracija. Čak su mnogi pisci koji su smatrani Bosancima bili skloni da pišu o Bosni kao "tamnom vilajetu i kazanu koji stalno vri". Ima li danas spisatelja koji su spremni da ispričaju pravu priču o Bosni i koliko je interesovanje publike da tu priču čuje?

Taljić: Ivo Andrić nije gajio prikriveni animozitet prema muslimanima. On je to radio najtransparentnije. Akademik Muhamed Filipović je, negdje pred ovaj posljednji rat, izjavio da je Andrić svojim pisanjem nanio više štete Bošnjacima i Bosni nego sve vojske koje su protutnjale kroz njihovu dugu historiju. I posljednji rat je osvjedočio pogubnost Andrićevoga pisanja, odnosno tumačenja njegovoga pisanja i njegovoga veličanja. Kad su u pitanju Bošnjaci koji su pisali tako kako ste naveli, ja ih ne branim, ali je i vakat u kome su pisali bio takav, težak, ne može se reći da im je bilo lahko. Da bi napisali jednu poštenu rečenicu morali su oko nje naredati desetine nakaradnih... A ima li sada pisaca koji su spremni...? Koliko se god mi između sebe kritizirali, ipak ja mislim da smo mi bolji nego što mislimo o sebi. Zato smatram da ima takvih pisaca i da će ih, ako Bog da, biti još više. Bošnjaci su narod Knjige, dio ummeta koji je prihvatio posljednju Božiju Objavu, i nama je, dakle, čitanje farz. Na svim nivoima moramo zagovarati obavezu čitanja, ali i izgrađivati čitalačke kriterije. Objavljuje se previše toga što nije vrijedno pažnje. Čitanje slabih knjiga je gore od nečitanja.

Novinari i pisci se najmanje vezuju za vjeru. Ipak, Vaša djela, osim historije, odišu i islamom. Koliko nadležne državne institucije uvažavaju takvog pisca koji ne krije svoju privrženost islamu i koji ne bježi od pisanja o stradanju svog naroda?

Taljić: Nedavno je, naprimjer, prvi put dodijeljena

nagrada «Hasan Kaimija». Ja sam napisao roman o Hasanu Kajimiji koji je, pod naslovom «Put iz Mekke», objavila izdavačka kuća «El-Kalem» Rijaset Islamske zajednice. Naš značajni pisac Nijaz Alispahić – koji je, inače, iz Zvornika, gdje je Kajimija bio u surgunu, a Kaimijina nagrada se dodjeljuje ispred Bošnjaka Zvornika – napisao je, povodom moje priče «Bijela kamena jaja», da sam nadvisio sve koji su se bavili pisanjem o Kaimiji. Ta priča je, inače, dio toga moga romana, romana o Kaimiji. To je moja najbolja knjiga. Ali, taj roman uopće nije bio uvršten u konkurenciju za Kaimijinu nagradu. Dakle, kad je tako s Kaimijinom nagradom, koja je bošnjačka književna nagrada i samo su se Bošnjaci pitali o toj nagradi, postaje jasnije kako se ponašaju Bošnjaci u multikulturalnim forumima kakav je taj Federalni fond za izdavaštvo. Tim fondom dr. Ivan Lovrenović, ali je on kriv utoliko što napokon ne smijeni te svoje bošnjačke dođvorice, kojima je stalo da se finansiraju njihova sabrana nedjela i nekvalitetne knjige drugih Bošnjaka. Tako oni sebi omogućuju «nedodirljivo» mjesto u sadašnjosti bosanske i bošnjačke književnosti. Čim takvi odu u penziju, niko ih se više neće ni sjećati, jer su i njihove knjige takve. Toga zaista ima, ali i mi sami činimo da je to znatno prisutnije nego što odista treba biti. Uistinu, opet ima tih «mangu-pa u našim redovima», ateista, neokomunista i sličnih prišipetlji, ali im i sami pridajemo prevelik značaj i kao takve ih uzdižemo. Možda i zato da bi nam bili alibi za nečinjenje. Na kraju, niko nikome ne brani da piše i o stradanju bošnjačkoga naroda ili da mu je pisanje prožeto vjeron. Ponavljam, istina je da se to nastoji sputavati, ali je nepobitno i to da Bošnjaci u Bosni, time i književnici, nikad nisu imali veću slobodu. Možda su se mnogi toga uplašili...

Je li danas u Bosni isplativije stvarati djela koja govore o ogromnim žrtvama rata ili o međunacionalnoj-homoseksualnoj ljubavi?



Taljić: Dobro je da ima djela i s takvom tematikom. Time se to razotkriva. Treba pisati i o nacionalnoj nastranosti, jer bi bilo pogubno zmiriti nad nečim što postoji u ime lažnog, licemjernog međusobnog poštovanja. Kad su u pitanju knjige o ogromnim ratnim žrtvama, pisci tu trebaju naći pristup koji neće odbijati čitaoca, koji će privući čitaoca da čita takve knjige, pogotovo što je moćna propagandna mašinerija usmjerena protiv pisanja takvih knjiga.

Agresija na Bosnu i Hercegovinu je česta tema bosanskih pisaca. Dok, s jedne strane, svi pišu o tome, malo ko obrađuje historiju Bošnjaka za vrijeme Austro-Ugarske ili Turske. Je li agresija jedina nepresušna tema bosanskih pisaca i mislite li da je nova bosanska književnost osiromašena kad su u pitanju priče i o "starom zemanu"?

Taljić: Bar pola moga «Romana o Srebrenici» odnosi se na vrijeme pod Austro-Ugarskom, a u mojim knjigama itekako ima i o vaktu pod tu-

rskom upravom. Naši književnici trebaju pisati o svim zemanim, jer je naša ukupna književnost, objektivno gledajući, više nego krhka, izuzimajući, naravno, pojedince i tzv. narodno stvaralaštvo, pogotovo naše epske i lirске narodne pjesme.

Čitajući Vaša dijela može se steći utisak da svoj narod opisujete kao ničiji i svačiji, a najmanje svoj. Može se reći da je to sudbina svih muslimana Balkana. Gdje su danas balkanski muslimani i koliko su oni između sebe (ne)povezani?

Taljić: Objavio sam 14 knjiga proze i niujednoj Bošnjaci nisu svačiji i ničiji, nego su isključivo svoji. Drugo je pitanje naše suočenje s istinom da je naš narod kroz historiju naviknut da su drugi iznad nas (Turci, Ugri, Madari, Srbi/Crnogorci, «bratstvo-jedinstvo»), da smo mi «ogrežli» u navici da drugi nama vladaju, pa se to pretvorilo u strahobolnu spoznavu da smo mi, zapravo, veliki podrepaši! I to sebi trebamo priznati. Zapravo, moramo to ukoliko želimo opstati kao narod i potpu-

no se oformiti kao nacija. Evo, sad smo napokon u poziciji i da zaista vladamo u Bosni, makar to bilo i ravnopravno s drugim tzv. konstitutivnim narodima. Ali, mi to ne umijemo. Satrasmo se zatirući se između sebe. Ja sam živio u Krajini odmah poslije prekidanja posljednje oružane agresije na Bosnu. Tih godina su tamo bili samo Bošnjaci, koji su i inače tamo bili bar s dvotrećinskom većinom. Tada je tamo postajala samo SDA, ali su Bošnjaci u njoj jedni drugima «vadili oči». Sada i tamo ima više bošnjačkih partija, ali je SDA ovih dana sama oborila svoju Vladu u Unsko-sanskom kantonu. Ili, u Sandžaku ima još više bošnjačkih partija. Pa, nek i ima. Ali, zašto jedni drugima «vade oči» i jedni protiv drugih se ujedinjuju sa svojim stvarnim neprijateljima? Isto su činili muslimani u Endelusu (muslimanskoj Španiji) sve dok ih tamo nije potpuno nestalo.

Može se reći da nema generacije balkanskih muslimana odrasle u 20. stoljeću a da nije osjetila stradanja na svojoj koži. Kakva, prema Vašem mišljenju, budućnost očekuje generacije koje dolaze i postoj li recept po kome će izbjeći greške svojih predaka i pod pritiscima apetita drugih ipak ostati svoji?

Taljić: Dugo godina pišem roman o Endelusu, a sve misleći da bi to morala biti velika opomena Bošnjacima. Kad već kao totalna objektivnost postoji «prokletstvo muslimana», jer znamo da Allah, dž.š., nije primio dovu Poslaniku Muhammedu, s.a.v.s., da mu ummet bude jedinstven, i kad znamo da se to nejedinstvo iznova i iznova iskazuje, zašto i dalje mi Bošnjaci «izginusmo» insistirajući na nekakvom građenju toga našeg nemogućeg jedinstva? Zašto ne odredimo bar minimum onoga što nam je nesumnjivo zajedničko i na osnovu toga gradimo povjerenje između sebe? Ovakvo, kad smo sami sebi neprijatelji, našim stvarnim neprijateljima je mnogo lakše s nama.

Razgovarao:
Samir Kajoshaj

ELIF

gazetë islame

Shehrun Mubarek! (Dialog me shpirtin e Ramazanit)

"Ju erdhi Ramazani, muaji i begatisë.
Ju mëshiron All-llahu në të,
duke iu fshirë me mëshirën e Tij gabimet tuaja
dhe duke iu përgjigjur lutjeve tuaja.
All-llahu shikon në adhurimin tuaj
dhe mburret me ju para melekëve.
Tregoni pra, All-llahut nga vetja juaj vetëm të mira,
i shkretë është vetëm ai,
që s'e meriton mëshirën e All-llahut në këtë muaj".
(Transmetuar nga Tabaraniu)

Në një nga netët e fundit të muajit të madhërueshëm Shaban, ndjeva filladet e Ramazanit, që më sollën pranë zemrës, mendjes e shpirtit tim, vetë shpirtin e Ramazanit të Begatë. Dritat e asaj nate më bashkuan me shpirtin e Ramazanit dhe një sërë pyetjesh m'u mbloodhën në zemër, që doemos kërkonin një përgjigje.

Dialogu me shpirtin e Ramazanit është përherë ngazëlues, ngjall prehe, jep mbarësi, tërheq vëmendjen nga hutimi, fal dhunti, dritëson...

O Muaj i begatë, fillova ta pyes mikun hyjnor kam dëshirë të dij se si parapërgatiten besimtarët, punëtorët, njerëzit e zellshëm, ata të dijes, urtësisë e udhëzimit për të të prituri?

Ah, sa të vëmendshëm janë ata, për të shfrytëzuar mbi të gjitha kohën time, në mënyrë që ta angazhojnë atë me adhurime, bamirësi, falje e agjërim... Ah, sa ëmbël e këndojnë Kur'anin, sa bukur tingëllon zëri i tesbihëve të tyre, sa ngrohtë u rrjedh loti i pendesës e sa përgjyrueshëm shfaqet lutja e tyre... Ata, orë pas ore e ditë pas dite mundohen të përfitojnë nga stina ime, për të përfutuar edhe dëshminë e Resululllahut, që thotë: "Agjërimi dhe Kur'ani i ndërmyjetësojnë robit tek All-llahu ditën e gjykimit. Agjërimi thotë: O Zot, unë ia ndalova ushqimin dhe e pshet gjatë gjithë ditës, prandaj më prano mua për të! Ndërsa Kur'ani thotë: O Zot unë ia ndalova gjumin gjatë natës, prandaj më prano mua për të dhe i ndërmyjetësojnë". (Transmetuar

nga Ahmedî, Tabaraniu, Haki-mi dhe Bejhakiu nga Ibni Amr (r.a.))

O Muaj i mëshirës, faljes e amnestisë hyjnore nga ndëshkimi i merituar, më trego të lutem, se si të presin Myftilerët me çallma të bardha?

Ata, ngrysin netët duke menduar e planifikuar për 30 ditët e prezencës time në mesin e besimtarëve. Sëbashku me teologët e thirrësit, ata mblidhen sikur anëtarët e një familjeje të madhe e të lidhur ngushtë. Kuvendojnë, dialogojnë, ndajnë detyra, marrin përsipër angazhime, hedhin vështrimet e tyre nga horizontet e së nesërme dhe konkludojnë të rrethuar nga dritat e mbarësisë: "Dora e All-llahut është mbi duart e tyre" (Kur'ani: 48:10)... Tek i vështron sëbashku, të shqetësuar dhe të angazhuar për të zgjidhur "mundimet" e njëri-tjetrit, të duket se po prek shpirtin e cilësimit të sahabëve: "Janë të mëshirshëm ndërmjet vete" (Kur'ani: 48:29)...

Po Imamët e Hatibët?

Edhe ata të karakterizuar nga kjo frymë, luten që All-llahu t'u ndriçojë mendjet e tyre, që gjatë ditëve të mia të sjellin risi në lëvizjet e xhematit e aktivitetet e xhamive. Mendojnë për shtimin e derseve dhe mbledhjeve të ndryshme për të përmendur All-llahun në xhemat, sikurse sahabët bënin ditëve të epokës së nurit... Mblidhen për të kënduar hatme të shumta, ulen për të komentuar

ar Fjalën e All-llahut, thërresin për bamirësi e vrapojnë për të evidentuar familjet në nevojë...

Po për besimtarët e zakonshëm, çfarë më thua, o Muaji i mirësisë?

Besimtarët, të përkushtuar ndaj Fjalës së Krijuesit të tyre, vrapojnë të shtojnë dhikrin e emrave dhe cilësive të Zotit të tyre dhe i luten Atij, që t'i veshë me cilësitë e atyre, për të cilët thotë: "E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqë!". Dhe që për hir të Zotit të tyre natën e kalojnë duke i bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë (falen). Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, largoje prej nesh vuajtjen e Xhehennemit, e s'ka dyshim se vuajtja në të

mira, të tillëve All-llahu të kërkijat ua shëndreron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai fal shumë. Ai që është penduar dhe ka bërë mirë, në të vërtetë, ai është kthyer te All-llahu dhe është i pranishëm. (Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet. Edhe ata që kur këshillohen me ajetet e Kur'anit të Zotit të tyre, nuk u kthejnë shpinën si të shurdhët e të verbër. Edhe ata që thonë: "Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit". Për shkak se duruan, të tillët shpërblehen me një shkallë të lartë (Xhennet) dhe aty priten me përshëndetje të selamit. Aty janë përgjithmonë, e sa vendq-

lorë dhe plot mbarësi... Zgjoohen herët në syfyr dhe pasi hanë dhe pinë, përgatiten për të shkuar në xhami. Pas faljes së sabahut, ata qëndrojnë në xhami duke u lutur e duke përmendur Zotin e tyre deri në lindje të diellit. Falin namazin e duhasë dhe pastaj shkojnë nëpër shtëpi. Marrin librat dhe nisin punën e një dite të gjatë... Në drekë pushojnë pak dhe pasi zgjoohen, falin iqtindinë, këndojnë pjesën e programuar nga Kur'ani dhe përsëri marrin studimet e hulumtimet e tyre. Akshami vjen shpejt. Pas iftarit marrin nga një pije të ngrohtë me të afërmit a miqtë dhe vrapojnë për në teravi... Kthimi i tyre në shtëpi është sinjal i përfundimit të një dite të mbushur me aktivitet, punë, studim e adhurim. Ata flenë herët dhe bëhen gati për një ditë të re...

O Muaj i dashur. Kam edhe shumë pyetje të tjera...

Mos, u nxito. Edhe pak ditë hëna e re do t'ju shënojë ardhjen time dhe më beso se, realiteti i ditëve do të jetë përgjigjja ime për çdo pyetje tënde. Por mos harro: Unë vij vetëm një herë në vit dhe e kam zakon të shkojë shumë shpejt, I lumi ai, që do të dijë të përfitojë gjatë ditëve të mia, nga mëshira, falja, pranimiti, drita, pendesa, loti, sexhdja e zgjatur e duart e ngritura lart ...

Ishte jaci. Freskia e asaj nate shtatori, kishte hedhur peletin e saj mbi Shkodrën e lashtë. Po shkoja drejt xhamisë, kur filladet e ditave hyjnore të muajit Shaban, më sollën shpirtin e Ramazanit të bardhë... Ishte natë drite, që më dritat e dialogut të nurshëm, ndriçoi edhe qytetin tim... Dëshirova që ajo natë të mos kishte fund...

Muhamed Sytari,
Shkodër



është gjeja më e rëndë". Ai, vërtet është vendqëndrim dhe vendbanim i keq. Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështrënguar, por mbajnë mesatren e janë të matur. Edhe ata që pos All-llahu, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërrsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepra të

ëndrim dhe vendbanim i mirë është ai"... (Kur'ani: 25:63-76) Ata fillojnë të pakësojnë fjalët e tyre të pavlera, të distancohen nga thashethemet, nga përgojimi dhe të lidhin miqësi me heshtjen e të urtëve, atë që shoqërohet me meditim...

Po studentët e dijes, ata që kërkojnë dritën e dijes së dobi-shme, për të punuar me të e për t'u bërë udhëzues të sinqertë me baza të shëndosha diturie?

Ata, Zoti i ruajtë dhe u shtoftë mbarësinë, janë shembull

Fëmijët dhe lojërat e dhunshme kompjuterike

“Papritur u ngrit nga ku që ulur dhe filloi të bërtas. Dukej që tërbuar ngase nuk mund ta vriste njeriun që shtinte në të. U ul për të provuar përsëri. Çmendurisht shpresonte se kësaj here do të çlirohej nga njeriu përball tij. I shkaktoi humbje të mëdha rivalit. Më në fund, kur kundërshtari që shtrirë në një pellg me gjak, filloi të qesh pa-mëshirshëm. Vazhdimisht i përsëriste këto aksione. Dhunshëm po luf-tonte dhe përpiqej që sa më shumë t’i dëmtonte armiqitë e tij. Ndonëse e ëma ka disa herë që po e thërret për të ngrënë drekë, as që do të lëviz nga tavolina. Aq fort që zhytur në lojë sa që nuk ishte në gjendje të mendonte për diçka tjetër.”

Pamje të tilla tashmë janë bërë mjaft të zakonshme në shumë shtëpi dhe internet kafe. Si fëmijët ashtu dhe të rinjtë kalojnë kohën më të madhe duke luajtur lojëra të tilla kompjuterike. Përderisa për prindërit kompjuteri konsiderohet si domosdoshmëri e kohës moderne dhe si asistent për fëmijët në detyrat e tyre të shtëpisë, fëmijët kryesisht e marrin atë si një kuti lodrash. Ata fillimisht nisin me një synim të ciltër, por me kohë humbin qëllimin e tyre të parë. “Përdorimi i pa kontrolluar i kompjuterëve”, problem ky i përbashkët për shumë prindër, është gjithashtu një çështje shumë e vështirë për tu zgjidhur edhe për shumë ekspertë.

Si ndikojnë lojërat kompjuterike në ndërgjegjen dhe ardhmërinë e fëmijëve? A kanë lojërat me efekte pozitive një prezantim tërheqës?

Lojërat kompjuterike mund të klasifikohen në dy kategori. Të parat janë lojërat që ndihmojnë në zhvillimin e talentit, kuptimin e eksperimenteve jetësore dhe vlerave etike, përmes një metode argëtuese; të dytat janë ato lloj lojërash që nuk kontribuojnë ndonjë gjë në imagjinatën e fëmijëve dhe aftësitë për të menduar por, përkundrazi nxisin dhunë dhe sjellje imorale tek ata. Që të ndikojë një lojë në zhvillimin mendor, fizik

dhe shpirtëror të fëmijës, varet nga përmbajtja dhe kohëzgjatja e saj. Koha e lojës nuk duhet të jetë as shumë e shkurtër e as shumë e gjatë. Në mënyrë që të arrijmë një balancë të duhur në këtë çështje, së pari duhet t’i pajisim fëmijët me një edukatë mbi shpenzimin e mençur të kohës. Fëmijët që kalojnë kohën më të madhe në aktivitetet të padobishme, mund të mos jenë të vetëdijshëm në shpenzimin e kohës në mënyrë efektive edhe kur të rriten. Shkurt, fëmijët duhet të mësojnë vetëdijen e të vlerësuarit të kohës. Kalimi i kohës karshi kompjuterit shkakton pasivitet tek fëmijët dhe tek të rinjtë. Për më tepër, kjo rrit edhe stresin të cilin e përjetojnë ata më vonë. Në veçanti tek fëmijët aktiv, ky lloj pasiviteti shkakton një akumulim të energjisë e cila negativisht ndikon në sjelljet e tyre. Shfrytëzimi i energjisë në sporte të ndryshme është mjaft i vlefshëm për zhvillimin fizik dhe mental të fëmijës si dhe ngritjen e një vetëdije shoqërore të tij. Kurse në anën tjetër, harxhimi i kohës përball kompjuterit, prizon fëmijët dhe të rinjtë nga aktivitetet e ndryshme kulturore si lojërat grupe, studimi bashkarisht dhe marrja me aktivitete sportive.

Shumë nga ne ankohemi se fëmijët tanë nuk janë të aftë të shprehin ashtu si duhet, dhe nuk janë të qartë në komunikim me mjedisin e tyre. Po t’iu bësh një pyetje, do të marrësh një përgjigje ose të shkurtër ose të zakonshme. Koha e kaluar përball kompjuterit luan një rol shprehës në këtë drejtim.

Ne po vërejmë se në çdo llojë të re kompjuterike niveli i dhunës sa vjen e shtohet. Prodhuesit e lojës e konsiderojnë të lejueshme çdo lloj metode vetëm që t’i tërheq fëmijët drejt ekranit. Ka skena të cilat nuk janë të përshatshme për moshën e fëmijës për shkak të vetëdijës së tij të ulët. Fëmijët që i janë ekspozuar skenave të ndryshme të dhunës, shpesh janë të prirur drejt agresionit, frikës dhe panikut dhe në përgjithësi janë të egër dhe me tempera-

ment të shpejtë duke e konsideruar dhunën si një gjë të zakonshme. Reaksionet e fëmijëve të cilët shikojnë filma të dhunshëm dhe luajnë lojëra të egra dhe të errëta kompjuterike, ndryshojnë me kohën duke filluar të aplikojnë sa më tepër forcë kundrejt njerëzve dhe fëmijëve përreth. Ata tentojnë t’i godasin dhe shkelmojnë të tjerët qoftë edhe pas një mosmarrëveshje të lehtë. Të prekur nga skena të dhunshme shkatërruese, tek ta shfaqen probleme të shumta, si shqetësimi i tepruar, trazime gjatë gjumit dhe çrregullime të sjelljeve. Përderisa shkaqet dhe efektet e sjelljeve të influencuara nga pesë shqisat nuk vihen shumë në pyetje tek fëmijët parashkollor, abnormalitetet e përmendura pak më lart mund të vërehen dukshëm në ta. Ja disa raste që na shërbejnë si shembull:

“Një fëmijë tre vjeçar i cili shikonte filma të dhunshëm, zbatoi atë që kishte parë në TV duke shpuar dhe therur vëllanë e tij me thikë. Një fëmijë tjetër i cili mendoi të bëhej pokemon (një karakter i filmave vizatimor), u hedh nga kati i shtatë duke dashur të fluturojë. Një fëmijë tjetër në Francë duke mos fituar asnjë lojë kompjuterike u bë epileptik për shkak të momenteve të shpeshta të zemërimit si pasojë e lojërave të pasuksesshme.” Fatkeqësisht shpesh dëgjojmë lajme të tilla. Në mënyrë që ta ndriçojmë vetëdijen e fëmijëve tonë me gjëra të bukura dhe të pëlqyera, dashuri dhe altruizëm, duhet t’u ofrojmë alternativa me lojëra të dobishme dhe edukative.

Lojërat dëmtuese gjithashtu i pengojnë fëmijët të mësojnë kulturën e tyre, duke shkakuar kështu një korrozion kulturor. Lojëra të tilla i qojnë fëmijët tanë drejt një bote me veshje dhe frizura të çuditshme, ku armët shërbejnë si dekor. Në këtë botë të virtuoze nuk ekziston vlerë tjetër përveç “ forca ka të drejtë”. Veç kësaj, në shumicën e këtyre lojërave Islami paraqitet si bogimen (lugat) dhe Muslimanët si terroristë që meritojnë të vriten. Fëmijët e pushtu-

ar nga lojërat kompjuterike bëhen mjaft armiqësor ndaj rrethit të tyre. Ngase kanë vështirësi të krijojnë shokë rreth vetes, ata bëhen të robëruar nga kompjuteri, duke e izoluar vetveten nga shoqëria. I vetmi shok i fëmijës mbetet kompjuteri, por edhe përkundër kalimit të kohës me të, fëmija ndjen një vetmi të madhe përbrenda. Kështu që mbetet detyrë e prindërve që jo vetëm t’u ofrojnë aktivitetet të përshatshme fëmijëve të tyre por dhe arsyeshem t’ua rregullojnë kohën për të luajtur lojëra të dobishme kompjuterike.

Shumë karakter të këqinj që paraqiten nëpër lojëra kompjuterike lënë përshtypje të mbrapshta në zhvillimin personal të fëmijës. Është shumë e saktë se mesazhet që japin këto lojëra, si të genurit i fortë dhe i pa sfiduar, jo konsiderata ndaj jetës së të tjerëve, të vrarit për hir të së jetuarit, përbuzja e vlerave etike, përgjigjeve të njerëzve të tjerë, jorespektimi i personit që i adresohemi, kategorizimi, etj. negativisht dëmtojnë zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Lojërat e këtualla gjithashtu kanë një rol negativ mbi aftësitë e të mësuarit si dhe vetëdijës së fëmijës. Skenat të cilat shpejt ndërrohen në ekranin e kompjuterit e hutojnë fëmijën me të madhe, ia çrregullojnë mendjen dhe e bëjnë mjaft konfuz. Kjo sjell vështirësi në koncentrim gjatë të mësuarit. Veç kësaj, ndërrimi i shpeshtë i dritave mund të shkaktojë kriza epileptike tek disa fëmijë.

Përfundimisht, lojërat kompjuterike inspirojnë fëmijët ngase edhe vetë jeta është vetëm një lojë dhe i shpie ata që të mëndojnë shumë rreth personazheve të lojërave duke qenë fizikisht dhe mentalisht me ta gjatë gjithë kohës. Lojërat e shpeshta kompjuterike, bëjnë që fëmijët t’i bartin konceptet e lojës në relacionet e tyre të përditshme me familjen dhe shokët, shkaktojnë konfuzion tek ta në mes realitetit dhe imagjinatës, kalojnë shumë pak kohë së bashku dhe gradualisht sjellje jo shoqërore integrohen nën

personalitetin e tyre.

Asesi, nuk duhet nënvlerësuar anët përfituese të kompjuterit i cili është një domosdoshmëri për kohën moderne. Andaj është ideale që të përfitojmë nga shërbimet pozitive të kompjuterit dhe të sigurohemi nga përdorimi i tij të dëmshëm. Koha e lojës, e cila është e domosdoshme për një rritje të shëndetshme të fëmijës, duhet të ndahet meqenëse në mes lojërave virtuale dhe lojërave të vërteta grupe. Mu për këtë ne duhet t’i preferojmë lojërat:

Ku fëmijët mund të luajnë një rol aktiv

Të cilat sygjerohen nga specialistët dhe ekspertët

Të cilat i pajisin fëmijët me një vetëdije kombëtare dhe identitet kulturor

Të cilat mbështesin të kuptuarit dhe inteligjencën e fëmijës

Të cilat kontribuojnë në virtytet pozitive, si të ndarit me të tjerët, shpirti ekipor, kujdesi për të tjerët, ciltërsia dhe diligenca (zelli dhe kujdesi).

Të cilat nxisin kureshtjen dhe bëjnë të mësuarin argëtim

Të cilat përfshijnë edhe prindërit në lojë

Të cilat ngjallin vetëdijen në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi

Të cilat ndihmojnë në zhvillimin e imagjinatës, aftësi mendore, aftësi zbuluese dhe shpikëse.

Po që se sytë, veshët dhe organet e tjera që na janë dhuruar nga ana e Krijuesit të Gjithë-mëshirshëm përdoren vetëm për lojëra kompjuterike argëtuese, atëherë ato po shfrytëzohen jashtë qëllimit të tyre esencial. Prandaj, mbetet përgjegjësi vitale e prindërve që t’i udhëzojnë fëmijët e tyre në përdorim të drejtë të shikimit, dëgjimit, ndijimit dhe aftësi gjyquese, me qëllim që t’u përgatitët një mjedis i cili siguron një të ardhme të pasur dhe të ndritur.

Marrë nga “The Fountain Magazine” – nr. 48, 2004, NY USA

Përktheu: Jeton Mehmeti

Intervistë me Shejh Shuajb Arnautin

Muslimanët duhet të lexojnë dhe studiojnë të gjitha hadithet dhe jo vetëm 40 hadithet e Neveviut

Bashkëpunëtori ynë ka biseduar me një prej dijetarëve më të mëdhenj botërorë, studiosin më të madh (që jeton) të haditheve, Shejh Arnauti, me prejardhje shqiptare, sqaron arsyet pse shumica e haditheve që flasin për Mehdiun janë daif - të dobëta, dhe flet për punën e tij shumëvjeçare dhe metodologjinë e Da' uetit

Për mendimin e shumë njerëzve, modestia, përkushtimi ndaj punës dhe zelli për të punuar, janë virtytet që karakterizojnë një prej recezentëve më të mirë të kryeveprave klasike dhe njëkohësisht njënjohësve më të mirë të shkencave të hadithit në kohën tonë. Shejh Shuajb Arnauti ka lindur në Damask më 1928. Babai i tij kishte bërë hixhret (ishte shpërngulur) nga Shqipëria për në Damask në vitin 1926, ku edhe ka jetuar Shejh Shuajbi deri në vitin 1983, prej nga mëpastaj është shpërngulur për në Amman, ku edhe jeton sot.

Duke punuar më shumë se 10 orë në ditë për 50 vite (që kur ka zënë të merret me këtë veprimtari) tok me kolegët e tij, ai ka bërë recenzurën e më shumë se 300 kryeveprave klasike. Me këtë rast vlen të përmendim vetëm disa prej tyre: "Zadul-mead fi hedji hajrul-ibad" Ibn Kajjim, në bashkëpunim me Shejh Abdulkadir Arnautin (5 vëllime); Begaviut "Sherh es-Sunneh" (16 vëllime), "Revdatu et-talibin" nga Neveviu, në bashkëpunim me Abdulkadir Arnautin (12 vëllime), "Sijer a'lam Nubela" nga Dhehebiu (25 vëllime), "Sherhul-akidete et-Tahavije" nga Ibn Ebil-Iza në bashkëpunim me dr. Abdullah ibn Abdul-Muhsin et-Turki (2 vëllime), "Tabekatul-Kurra" në bashkëpunim me dr. Beshar Aëad (2 vëllime), "Musned el-imam Ahmed ibn Hanbel" (50 vëllime), "Tahrir et-takrib" Ibn Haxher el-Askelani në bashkëpunim me dr. Beshar Evad (4 vëllime), "Sunen en-Nesai el-kubra" në bashkëpunim me Hasen Shelebi (12 vëllime), "Sunen et-Tirmidhi" (6 vël-

lime), "Sunen ed-Darekutni" në bashkëpunim me Hasen Shelebi (5 vëllime), dhe shumë vepra të tjera kapitale në gjuhën arabe, tefsire, hadithe, historitë islame, shkencave të transmetimit të haditheve etj.

Për Shejh Shuajbin ka shkruar edhe Omer Hasan el-Kijam në librin "Sherh mushkileti athar", të imam Tahaviut. Ky alim thotë që Shejh Arnauti është një prej tre alimëve të moçëm që jetojnë në ditët tona krahas Ahmed Muhamed Shakir dhe Muhamed Nasirudin Albanit; dhe se Shejh Shuajbi i ka tejkaluar këta të dy për nga numri i veprave të recenzuara, madje edhe në lëminë e metodologjisë së recenzimit të kryeveprave klasike. Nga këta të tre sot jeton vetëm Shejh Shuajb Arnauti.

Shejh i nderuar, kam patur rastin që në revistën "El-Kible" të lexojë një studim interesant mbi hadithet që flasin për Mehdiun. Respektivisht, në atë artikull vihet në dukje se dr. Adab Mahmud Hamesh dhe Shejh Abdur-Rezak ebul-Besal pas studimeve të thukëta erdhën në përfundim që, të gjitha hadithet mbi Mehdiun që arrijnë gradën e 'mutevatir m'anevi', janë në fakt daif apo të dobëta. Si e komentoni ju këtë, duke patur parasysh që kjo është një risi për shkencën e hadithit?

Shejh Arnauti: Bismilahi-rahmani-rahim. Falenderimet i takojnë Allahut s.v.t., Paqja dhe Shpëtimi qofshin mbi Pejgamberin Muhamedin s.a.v.s.. Është e udhës të vihet në sipkame që në fillim, se kur flitet për hadithet, të cilat kanë të bëjnë me Mehdiun, kanë shkruar, folur dhe kanë mbledhur

të dhëna shumë dijetarë. Mirëpo, sa më shumë që kemi mësuar aq më tepër i jemi ofruar mendimit se ato janë të dobëta, dhe se nuk lejohet që të mbështetem në to. Megjithatë, ekziston një numër i caktuar i tyre që janë hasen (të pranueshme), por sërish edhe ato mund t'i numërojmë me gishtërinjë. Veç këtyre, ka mjaft prej tyre që qëndrojnë mes të qe-


Cila është arsyeja që ato janë daif dhe nuk bien në kategorinë e haditheve të besueshme?

Shejh Arnauti: Arsyeja qëndron tek njerëzit që përmenden në zingjirin e transmetuesve të atyre haditheve.

A mund të presim edhe në të ardhmën diçka të ngjashme?

Shejh Arnauti: Fillimisht do të doja të vejë në dukje se nuk është Adab Hamsh personi i parë që ka treguar në këto ditë. Veç këtyre, ka mjaft prej tyre që qëndrojnë mes të qe-

eshme (të vërteta) dhe të dobëta, dhe një gjë e tillë më nuk bëhet", natyrisht që një opinion i tillë nuk është i drejtë. Shumica e dijetarëve konsiderojnë që ky proces do të zgjasë deri në Ditën e Kijametit, ngaqë kjo është një çështje e ixtihadit dhe dallon varësisht nga njeriu. Mbase pikërisht ju, derisa të lexoni librin e Mizzit, i cili ka përmbledhur biografitë e atyre që kanë transmetuar hadithet, do të arrini deri tek konstatimi që disa nga transmetuesit, të cilët disa nga kanë konsideruar si të besueshëm, në fakt nuk janë të bes-



Shejh Shuajb Arnauti

nurit 'daif' dhe 'hasen', por edhe numri i tyre është i papërfillshëm, dhe ajo që është më interesante është se edhe nëse janë nga 'mutevatir m'anevi' asnjë nga ato nuk janë të besueshme (sahiha). Njëherazi, kur është fjala për këto dy figura të shpikatura që përmendet, dr. Adabu Hamshu dhe Ebu Besal, duhet theksuar se puna e tyre është korrekte, e mirëfilltë, ndaj ne mund të përfitojmë nga veprat e tyre.

të parët që ka treguar në dobësitë e haditheve që flasin për Mehdiun.

A do të thotë kjo që mendimi se është mbyllur me shkencën e hadithit dhe nuk lejohen të futen gjëra të reja në të sipas jush nuk është i vërtetë?

Shejh Arnauti: Nëse aludoni në fjalët e Ibn Salah i cili ka thënë: "Është përmbyllur me vërtetimin e haditheve dhe kategorizimin e tyre në të besu-

ueshëm dhe nuk mund të merren hadithet nga ta.

Disa njerëz, konsiderojnë që nuk lejohet të dalim me gjëra të reja kur bie fjala për shkencën e hadithit.

Shejh Arnauti: Këtë nuk e thotë ai që posedon dije. Juristët Islam kur kanë shtjelluar një mes'ele (çështje) dhe për secilën prej tyre kanë sjellur argumente, nuk kanë ngulmur që patjetër duhet të merret

ajo deri tek e cila kanë arritur ata. Përkundrazi, Ebu Hanife, Maliku, Shafiu dhe Ahmed asnjëherë nuk i kanë thënë kujt që nuk i lejohet të dalë nga ajo çfarë kanë thënë ata, por përkundrazi, kanë thënë që; 'çdokush që vie tek ndonjë argument më të mirë dhe më të saktë nga kjo tek e cila kemi arritur ne, duhet ta pranojë atë dhe të hedh poshtë mendimin tonë'. Në këtë mënyrë kanë edukuar edhe nxënësit e tyre, të cilët kundërshtonin mësuesit e tyre më së shumti kur vinte puna tek gjetja e zgjedhjeve në Fikh. Kemi shembullin e Ebu Jusufit, nxënësit të Ebu Hanifës, i cili në shumë gjëra ka patur mendim të ndryshëm nga mësuesi i tij Ebu Hanife.

A është kjo karakteristikë e hulumtimit të veprave klasike prezente vetëm tek muslimanët, sa merren edhe jomuslimanët me këtë punë?

Shejh Arnauti : Ky konfirmim i haditheve, apo informatave burimore, është një gjë që ka bërë ummetin Islam të ndahet, karakteristikat e senedit (zingjirit) besueshmëria e tekstit gjithashtu dallojnë në botën Islame. Kur është shpallur Kurani, Pejgamberi s.a.v.s u ka mësuar atë sahabëve. Disa kanë dëgjuar, disa të tjerë kanë shkruar, të tjerë i kanë mësuar ato përmendsh, njësoj ka ngjarë edhe me hadithin e Pejgamberit s.a.v.s – sahabët e kanë mbajtur në mend (e kanë mësuar përmendsh) dhe ua kanë transmetuar atë të tjerëve. Në këtë mënyrë kanë arritur tek ne, do të thotë përmes zingjirit të transmetuesve. Nuk mendoj që do të ketë ndonjë fe tjetër që të ketë poseduar një karakteristikë të këtillë. Kam lexuar dikund që një prej mendimtarëve në perëndim, jomusliman, dhe i cili ligjëron në një prej universiteteve në Amerikë, të ketë pohuar se: "Metodologjia që përdorin muslimanët në studimin e haditheve të Pejgamberit s.a.v.s do të duhej të ishte metodologjia e vërtetimit të gjithë asaj që vie tek ne nga e kaluara apo historia, ngase kjo është metodologjia më e pranuar dhe më e mirë." Së këtejmi, nuk mendoj se ka ndonjë fe e cila trashëgiminë e vet historike e vërteton në mënyrë të saktë e bënë atë muslimanët. Nëse dikush mendon ndryshe do të doja të më bind në të kundërtën.

Gjatë recenzimit të librave, merrni për bazë origjinalin apo botimet më të reja të librit?

Shejh Arnauti : Ekziston 'tahirixhi' vërtetimi i besueshmërisë (burimit) të haditheve dhe të atyre që i kanë regjistruar ato, dhe 'tahkik' apo recenzimi. Kur bëhet fjalë për recenzim duhet paqetë që të kemi shkrimin origjinal. Atë çfarë ka shkruar autori apo nxënësi i tij.

'Sijeru el-alam en-Nubela' a keni patur librin në origjinal, dhe ku e keni gjetur?

Shejh Arnauti : Po, për recenzim e kemi shfrytëzuar kopjen origjinale të atij libri, të cilin e kemi gjetur në një bibliotekë në Egjipt. E kemi fotokopjuar dhe në bazë të asaj kopje të origjinalit është bërë recenzimi. Njëlljoh është vepruar edhe me kryeveprat e tjera. S'do mend se kur kemi bërë recenzimin e "Sunenu et-Tirmidhi" nuk i kemi gjetur të gjitha vëllimet e kësaj vepe në një vend. Diçka nga ato kemi gjetur në Indi, dhe pjesë të tjera në Sham dhe kështu unë kam ardhur tek mostra "Sunenu Et-Tirmidhi", të cilën e ka bërë nxënësi i nxënësit të Tirmidhiut, dhe i cili ka transmetuar hadithet nga ai. Ndërsa të tjerët punojnë edhe me botime të tjera, ne zakonisht në faqet e para botojmë një prej faqeve kopje të dorëshkrimit në origjinal.

Kush i lexon ato libra, a ekziston ndonjë person përgjegjës për leximin e tyre, meqë ato dorëshkrime të vjetra janë të paqarta dhe të vështira për t'u lexuar?

Shejh Arnauti : Unë i lexoj, me mjaft përkushtim dhe nuk has ndonjë vështirësi gjatë leximit të atyre dorëshkrimeve.

Sigurisht, ka pak njerëz që mund dhe janë në gjendje t'i lexojnë këto dorëshkrime të vjetra?

